

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga Aricoma Systems a.s., me seli të regjistruar në Hornopolni 3322/34, Moravska Ostrava, 702 00 Ostrava, Republika e Çekisë, përmes Tatjana Popovski Buloski, avokate nga Shoqëria e Avokatëve Popovski dhe Partnerët nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë 09.03.2026, solli këtë

### **AKTVENDIM**

1.Konstatohet se përqendrimi me të cilin Aricoma Systems a.s., me seli të regjistruar në Hornopolni 3322/34, Moravska Ostrava, 702 00 Ostrava, Republika e Çekisë, do të fitojë kontroll mbi asete të caktuara të SHA Dentsu International Switzerland, me seli të regjistruar në Giessenstrasse 18, 8005 Cyrih, Zvicër dhe asete të caktuara të Merkle S.L., me seli të regjistruar në Av Diagonal 177-183 kati i 7-të Barcelonë 08018 Spanjë, përmes shitblerjes së pjesëve të aseteve të ndërmarrjeve, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose cenimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

2.Detyrohet parashtruesi i njoftimit për përqendrim të paguajë taksën administrative për njoftimin për përqendrim në vlerë prej 6.000,00 den. dhe për aktvendimin në vlerë prej 30.000,00 den., sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për Taksat Administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04, 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10, 17/11, 84/12, 192/15, 23/16 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 151/21) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë nr. 100000000063095, llogaria e pagesës 840...03161, shifra e të hyrave dhe programi 72231300.

3.Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

### **Arsyetim**

Në përputhje me dispozitat e nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), më datë 05.02.2026 në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) u dorëzua njoftimi për përqendrim nga Aricoma Systems a.s., me seli të regjistruar në Hornopolni 3322/34, Moravska Ostrava, 702 00 Ostrava, Republika e Çekisë, përmes degës së saj të huaj zvicerane Aricoma Systems a.s. Ostrava (CZ), dega Gjenevë, përmes Fiduciaire de Rive me seli në rrugën de Rive 4, Zvicër, dhe përmes shoqërisë së saj të varur Avinga Technologies Spain SL, me seli në Calle Barcas 2, kati i 2-të, 46002 Valencia, Spanjë (të cilën Aricoma Systems a.s.) do ta fitojë nga një shoqëri tjetër e varur e Grupit KKCG para finalizimit të transaksionit, do të fitojë kontroll mbi asete të caktuara të SHA Dentsu International Switzerland, me seli të regjistruar në Giessenstrasse 18, 8005 Cyrih, Zvicër dhe

asete të caktuara të Merkle S.L., me seli të regjistruar në Av Diagonal 177-183 kati i 7-të Barcelonë 08018 Spanjë, me anë të shitblerjes së pjesëve të aseteve të ndërmarrjeve (biznes, kontrata dhe punonjës).

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin për përqendrim dhe shtojcat e tij, konstatoi si më poshtë:

### **Aktivitetet kryesore afariste të ndërmarrjeve të përfshira:**

Aricoma Systems a.s. fokusohet në zbatimin e projekteve të mëdha për klientë të mëdhenj, zbatimin dhe mbështetjen e sistemeve të informacionit të biznesit Microsoft Dynamics dhe ofron infrastrukturë të TI-së, aplikacione të korporatave, mbështetje të proceseve të biznesit, mbështetje për përdoruesit dhe siguri të TI-së.

Aricoma Systems a.s. i përket Grupit KKCG, i cili investon në fusha të ndryshme biznesi, duke përfshirë lotaritë dhe lojërat e fatit, energjetikën, patundshmëritë dhe teknologjinë e informacionit.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Grupi KKCG është i pranishëm në tregun e operimit me terminale për video-lotari dhe teknologji të informacionit përmes shoqërive të mëposhtme:

- Shoqëria për organizimin e lojërave të fatit CASINOS AUSTRIA INTERNATIONAL MAQEDONIA SHPK Shkup, me seli në bul. Kiro Gligorov nr. 2, Shkup – Gazi Babë, me veprimtari prioritare 92.000 - aktivitete të bixhozit dhe basteve;
- Shoqëria për organizimin e lojërave të fatit Videolotaria Shtetërore e Republikës së Maqedonisë - CASINOS AUSTRIA SHPK Shkup, me seli në bul. Kiro Gligorov nr. 2, Shkup – Gazi Babë, me veprimtari prioritare 92.000 - aktivitete të bixhozit dhe basteve;
- Shoqëria për teknologji të informacionit AVENGA SHPKNJP Shkup, me seli në 11 Tetori nr. 33A, Shkup – Qendër, me veprimtari prioritare 62.100 - programim kompjuterik;
- Shoqëria për edukim kompjuterik dhe zhvillim të inovacioneve AVENGA Academy SHPKNJP Shkup, me seli në 11 Tetori nr. 33A, Shkup – Qendër, me veprimtari prioritare 85.590 - arsimim tjetër i papërmendur diku tjetër;
- Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime Musala Soft SHPKNJP Shkup, me seli në 11 Tetori nr. 33A, Shkup – Qendër, me veprimtari prioritare 62.100 - programim kompjuterik.

SHA Dentsu International Switzerland është ofrues i teknologjive të specializuara për zgjidhje digjitale për kontrollin e zinxhirit të furnizimit, që u mundësojnë rregullatorëve, prodhuesve dhe shitësve me pakicë të monitorojnë pajtueshmërinë me kornizat ligjore, politike dhe kontraktuale për të parandaluar tregtinë e paligjshme me produkte të rregulluara.

SHA Dentsu International Switzerland nuk ka degë në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe nuk ka realizuar qarkullim në Republikën e Maqedonisë së Veriut gjatë vitit të kaluar.

Merkle S.L. fokusohet në planifikimin strategjik, menaxhimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të përvojës së klientit përmes analizës sistematike, përpunimit dhe interpretimit të të dhënave përkatëse, si dhe përmes ofrimit të shërbimeve profesionale konsulente në fushën e teknologjive të marketingut, duke përfshirë përzgjedhjen, zbatimin, integrimin dhe optimizimin e mjeteve dhe platformave digjitale me qëllim përmirësimin e efikasitetit të aktiviteteve të marketingut dhe forcimin e marrëdhënieve me klientët.

Merkle S.L. nuk ka degë në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe nuk ka realizuar asnjë qarkullim në Republikën e Maqedonisë së Veriut gjatë vitit të kaluar.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i njoftuar bie nën dispozitat e Ligjit, pasi plotëson kushtet nga neni 12 paragrafi (1) dhe nga neni 14 paragrafi (1) pika 1) dhe 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret nga neni 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe pikës 6 b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht do të konstatojë se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës*, vlerësoi se përqendrimi i njoftuar, megjithëse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të pasi nuk do të ketë si pasojë pengimin, kufizimin ose cenimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive në treg ose në një pjesë thelbësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve.

Duke marrë parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit.

Në përputhje me nenin 53 paragrafi (2) të Ligjit, padia nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

#### **Udhëzim për mjetin juridik:**

Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet padi për ngritjen e kontestit administrativ pranë Gjykatës Administrative në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

**KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS  
KRYETARE**

**Mr. Малинка Силјановска Николиќ**